

## Gjëra të Vogla, Ndryshim i Madh (pjesa 4 nga 4)

Gëzohem që keni ardhur për të festuar me familjen e kishës sonë. Sot mbylлим serinë “Gjëra të Vogla, Ndryshim i Madh.” Cila ka qenë fjalja që kemi përsëritur gjatë gjithë këtyre javëve?

**Gjërat e vogla, ato që nuk i shikon njeri, sjellin ndryshimet e mëdha që i dëshiron çdo njeri.**

Në javën e parë kërkuam një fjalë kyçe: **Fokusohuni.**

Në javën e dytë kërkuam një mendim: **Do të forcoj atë që kam...**

Në javën e tretë kërkuam një thënie: **Unë jam i fortë në Ty, Zot.**

Kemi parë mendimet dhe fjalët, sot do të fokusohemi te zakonet e jetës së përditshme, ose disiplinat e jetës së përditshme. Cila është ajo gjë që duhet ta ushtrojmë derisa të bëhet zakon i përditshëm?

Sa persona të disiplinuar ka në sallë? Kush do të thotë: "Unë jam i disiplinuar"? Zoti ju bekoftë shumë!

Kush do të dojë të jetë një çikë më shumë i disiplinuar në jetën e tij të përditshme?

Tani... e pranojmë ose jo, të gjithë kemi disa gjëra ku jemi të disiplinuar. Ti do të thuash: "Por jo unë, unë jam i disiplinuar vetëm për të luajtur lojëra me celular ose kompjuter, ose për të ulur në kafe 20 herë në ditë."

Jo, ore jo! Ti je i disiplinuar në diçka. Po e gjeta, unë jam i disiplinuar për të fikur alarmin e telefonit çdo mëngjes, ama çdo mëngjes e fik. Ose, kur vjen ora për të ngrënë, nuk lë asnjë vakt pa ngrënë. Jam i disiplinuar te vaktet.

Po, e gjeta, unë jam i disiplinuar, sepse rregullisht... Nuk kam pikë disipline. A quhet disiplinë kjo?

Çfarë mund të quajmë disiplinë? Është **të zgjedhësh mes: çfarë do tani dhe çfarë do më shumë.**

Më thjesht se kaq nuk bëhet.

Të zgjedhësh mes asaj se çfarë do tani dhe çfarë do më shumë. Të gjithë jemi të disiplinuar në zona të ndryshme të jetës.

P.sh., nëse ti thua: “Unë jam mirë me shkollën,” kjo do të thotë që ti je i disiplinuar në disa gjëra, si në orarin e studimit, bërjen e detyrave, paraqitjen në mësimet, etj.

Nëse ti thua: “Kam një martesë të mirë,” kjo do të thotë që ti je i disiplinuar në disa gjëra, si të hani darkë bashkë, të diskutoni gjërat bashkë, të luteni bashkë, ose të drejtoni një grup të vogël bashkë si çift.

Nëse ti thua: “Kam një shëndet të mirë,” ka mundësi që kjo do të thotë se je i disiplinuar në disa gjëra, si në mënyrën se si ushqehesh, ushtrohesh, dhe sa orë gjumë fle...

Nëse ti thua: “Kam shoqëri të mira,” ka mundësi që kjo do të thotë se je i disiplinuar në disa gjëra, si takoheni rregullisht dhe bëni për njëri-tjetrin rregullisht.

Ose e kundërta: në gjërat ku ti nuk je mirë, do të thotë që ke disa disiplina, zakone jo shumë të mira. P.sh., jam shumë ngushtë financiarisht. Ka shumë mundësi që i shpenzon paratë duke blerë gjërat direkt sapo të kesh lekë në dorë. Ose thua: “Do të dobësohem një çikë këtë vit.” Dhe fillove mirë: të hënën u ngrite herët, bëre vrap, bëre dush, hëngre diçka të lehtë atë ditë. Të martën, po binte një çikë shi. Të mërkurën ka qenë dita më e ftohtë e vitit, le të mos e përmendim që të dhimbte një këmbë shumë. E fillove mirë, por s’e mbarove mirë.

Ose thua: “Do të disiplinom në gjërat që ha.” Të hënën dhe të martën ishe mirë, pastaj ia kercite prapë me byrek, bukë me qofte të zgara, dhe suflaqe për shpërlarje, sepse ishe i zënë, s’kishe kohë. Dhe e humbe vrullin që fillove.

Ose thua: “Do të disiplinohem në kohën me Zotin.” Fillove mirë, çdo mëngjes fillove të zgjohesh 15 minuta më herët, por pastaj kishte një film të bukur dhe re shumë vonë. Kishe njerëz për darkë dhe nuk zgjoheshe dot më aq herët.

Situata të tilla, ku e nise mirë por e humbe rrugës vrullin që nise, ngjajnë me momente në jetën tonë, apo jo? Po kemi dhe një shok tjetër, nuk jemi vetëm. Apostulli Pali, ai që shkroi shumicën e Dhjatës së Re, një nga drejtuesit më të fortë në historinë e Krishterimit, ai kaloi të njëjtin problem.

Te Romakëve 7, ai flet shumë hapur. Ai ndihet ndonjëri kështu:

**Romakëve 7:15** *'Sepse unë nuk kuptoj atë që bëj, sepse nuk bëj atë që dua, por bëj atë që urrej.'*

Dua të bëj gjënë e duhur, por nuk mundem. S’dua të bëj gjënë e gabuar, por atë shkoj e bëj. Kështu është, apo jo?

Unë dua të ha një mollë, por ajo qesja e patatinave po më bën me sy. Dua të bëj gjënë e duhur, por përfundoj duke bërë gjënë e gabuar.

**Romakëve 7:20** *'Edhe, në qoftë se bëj atë që nuk dua, s'jam më vetë ai që e bëj, por është mëkati që banon në mua.'*

Nuk jam unë ai. Kjo është e bukur; natyrshëm, ne nuk jemi të vetë-disiplinuar. Natyrshëm, mëkati na tërheq, na shtyn larg Perëndisë, larg asaj që do Perëndia.

Natyra mëkatore na shtyn drejt të keqes, jo drejt së mirës. Ne duam të bëjmë të mirën, por natyra mëkatore na josh për të na larguar nga Perëndia, na tundon për të bërë të keqen.

Kush nga ju është ndjerë si:

**Romakëve 7:24** *'Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes?'* (Kush do të më çlirojë nga mëkati dhe vdekja?)

Kush mund të më ndihmojë ta mund tundimin? Kush mund të më ndihmojë të rri larg mëkatit? Kush mund të më ndihmojë që të qëndroj larg mëkatit? Kush mund të më ndihmojë që të kem dhe të jem i disiplinuar?

**Romakëve 7:25** *'I falem nderit Perëndisë me anë të Jezu Krishtit, Zotit tonë. Unë vetë, pra, me mendjen, i shërbej ligjit të Perëndisë, por, me mishin ligjit të mëkatit.'*

E veçanta është, përgjigja nuk gjendet në një parim, por te një Person. Kush do të më çlirojë? Përgjigja është: Jezu Krishti, Zoti ynë.

Me ndihmën e Tij, unë mund të jem ndryshe. Me ndihmën e Tij, unë mund të ndryshoj. Me fuqinë e Tij, mund të transformohem.

Javën e shkuar ju nxita për të pasur një thënie që do e përsërisni shpesh. Cila ishte? **"Unë Jam i Fortë në Zotin!"**

Jo me forcën as me fuqinë, por me Frymën e Zotit. Jo unë, s'jam i fortë vetë, por jam i fortë kur Zoti Jezus banon në mua me Frymën e Tij.

Nuk jam i fortë në veten time, nuk jam i fortë me forcën e vullnetit tim, sepse mëkati që është në mua do atë që është e keqe. POR Krishti në mua është forca ime, më i fortë se mëkati, më i fortë se dëshirat e mia, më i fortë se zakonet e mia koti, më i fortë se forca e mëkatit.

Disa nga ju mund të jeni përpjekur shumë për të ndryshuar, por sot është dita për t'u çliruar. Me fuqinë tënde, ti s'ke për të qenë i vetë-disiplinuar, sepse vetja jonë na shtyn drejt mëkatit.

Por kur Fryma e Perëndisë merr kontrollin e jetës sonë, e njëjta Frymë që ringjalli Krishtin nga vdekja, atëherë mund të kemi një frymë të disiplinuar për të bërë atë që do Perëndia.

Kush mund të më çlirojë nga ky trup i vdekjes? Falenderoj Perëndinë që zgjidhja është në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Me fuqinë që më jep Jezusi, *unë mund të zgjedh së pari atë që dua më shumë para asaj që dua tani*. E ushtroj veten në gjërat që janë më të rëndësishme. Po si bëhet kjo? Si të kalojmë nga këtu ku jemi për të qenë aty ku duam të jemi?

Pali e shpjegon bukur ushtrimin, krijimin e disiplinës, kur flet për një garë të cilën e njihnin të gjithë, Lojrat Ifmeon që luheshin në Korinth. Afër këtij tempulli bëheshin lojrat. Këto lojra sillnin krenari patriotike. Siç kemi ne sot Lojrat Olimpikë, nëse ti fiton një medalje ari në një disiplinë sporti, p.sh. në garën e hedhjes së diskut, është si të thuash se gjithë vendi yt ka fituar, sepse ti përfaqëson gjithë kombin në këto lojra.

Duke patur këtë në mendje, Pali tha

**1 e Korintasve 9:24-25** *'A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni. Dhe kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha; dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që prishet, kurse ne për një kurorë që nuk prishet.'*

Sportistët ushtrohen për të garuar në këto gara. Kështu edhe ti dhe unë, duhet të ushtrohemi në atë që duam, që pastaj të... *Vraponi në mënyrë që ta merrni, që ta fitoni*. Të gjithë atletët e kontrollojnë veten në të gjitha, janë të disiplinuar në trajnimin e tyre për të fituar një kurorë që prishet, një kurorë me degë ulliri, ndërsa ne për një kurorë që nuk prishet.

Pali thotë: "Ti mos vrapo sa për t'u dukur sikur po vrapon, ti vrapo duke dhënë maksimumin ndaj thirrjes që ka dhënë Perëndia për ty. Mos vrapo për medalje bronzi, vrapo për medalje ari, vrapo për të fituar."

Atletët, sportistët, për të marrë pjesë në këto gara ushtroheshin fort për 10 muaj. Hanin ushqime të caktuara; nuk lejohej alkooli ato 10 muaj, as qofte e as byrekë trekëndësh. Por ushqeheshin vetëm me ushqime që ua forconin trupin.

Stërviteshin në mes të vapës dhe në temperatura të ftohta për t'i mësuar trupit të tyre të vraponin për të fituar.

Dhe kur vraponin, ishin aq të fiksuar pas garës, saqë i grisnin rrobat që të mos i pengonin dhe garonin lakuriq për të qenë sa më të shpejtë.

Ky varg ka lidhje me këtë që po them:

**Hebrenjve 12:1** *'Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, duke hedhur tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon*

*vazhdimisht duke na joshur, le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh,'*

Kur tha, "duke hedhur tej çdo barrë," në kontekstin e tyre, çfarë kuptimi kishte? Bluza që kishin, rrobat që kishin veshur? Djemtë lakuriq duke vrapuar dhe thonë pastaj: "Pse kishte kaq shumë vajza duke parë garat e lojërave atëherë?" (shaka)

Pra, ti dhe unë vrapojmë në garën e jetës për të fituar, jo sa për të bërë sikur po vrapojmë. Siç thotë vargu 25:

**1 e Korintasve 9:25b** '*... dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që prishet, kurse ne për një kurorë që nuk prishet.'*

Ata vraponin me pasion për të fituar një rrethore me degë ulliri. "Merre, ta gëzosh, ti fitove! Kujdes, mos ta ha dhia në shtëpi se janë gjethe, vendose lart sipër raftit."

Kurse ti dhe unë, ne ndjekësit e Krishtit, jetojmë për lavdinë e përjetshme, për kurora që nuk fishken. Ne jetojmë, ne vrapojmë që të dalim para Perëndisë së lavdishëm një ditë. Ne jetojmë për t'i dhënë atij lavdi dhe të përdorim çdo gjë që kemi për ta bërë të njohur emrin e tij.

Pra, ne nuk jemi thjesht të vet-disiplinuar; ne jemi të disiplinuar nga Fryma. **Fryma e Perëndisë na ndihmon që ta mposhtim fuqinë e mëkatit.**

Kush mund të më ndihmojë që ta mposht tundimin dhe fuqinë e mëkatit në jetën time, që unë të ec përpara dhe të bëj atë që dua dhe jo atë që nuk dua? **Fryma e Perëndisë. Lavdi Zotit!** Kjo gjendet në Jezu Krishtin, Zotin tonë. Ai e ka këtë fuqi dhe e vë në dispozicionin tonë.

Pali thotë: "Unë vrapoj me synim të qartë në çdo hap që hedh. Nuk vrapoj sikur rrah erën, nuk vrapoj sa për ajër, kot vërdallë. Nuk vrapoj sikur po mund një armik imagjinar, jo, jo; po vrapoj për të mundur armikun e vërtetë, Satanin, që vjen për të vjedhur, për të vrrarë dhe për të shkatërruar. Dhe për këtë gjë, unë jam i trajnuar me fuqinë e Perëndisë që është brenda meje, e cila është armë e fuqishme, dhe kësaj arme nuk ia kalon asnjë lloj arme në botë. "

**1 e Korintasve 9:27a** '*madje e mundoj trupin tim dhe e nënshtroj...'*

E bëj trupin tim të bëjë atë që duhet, jo me fuqinë time, por me fuqinë e Perëndisë. Që të mos bëj atë që dua unë, por të bëj atë që lavdëron Perëndinë. **Çdo hap që hedh do e hedh me qëllim të qartë.**

**Unë do të bëj që në fillim atë që dua më shumë dhe jo atë që dua tani.**

Dhe me këtë mendësi, ti je më i qëllimshëm në hapat që hedh. Ti hedh një hap dhe thua: “E di çfarë, unë mund të bëj edhe pa këtë, kështu që po i kursej paratë për atë që dua më shumë.”

E di çfarë do ha një gjellë sot, aq më shumë që është muaj provimesh; dua të jem i shëndetshëm dhe në formë.

Do kujdesem për familjen time; do investoj më shumë kohë te fëmijët e mi. Do investoj kohë me Perëndinë; dua të jem i fuqishëm në Zotin.

Jam shumë i inkurajuar nga ju; sa shumë djem dhe vajza kanë filluar ta lexojnë Biblën këtë vit, me synimin për ta lexuar nga kapaku në kapak. Filloje dhe ti!

Fuqia e Perëndisë banon brenda meje; e njëjta fuqi që ringjalli Jezusin banon në mua. Unë do të vrapoj me synim të qartë në mendje, sepse dua t'i sjell lavdi Perëndisë sot; e di që Ai do të më drejtojë hapat e mi.

Fryma e Perëndisë më drejton në çdo gjë që bëj. Unë jam i dobët; unë dua atë që është më e lehtë dhe më e këndshme për mua, atë që më bën të ndihem mirë.

Por para gjithë këtyre gjërave, unë dua t'i sjell kënaqësi Perëndisë tim; dhe për shkak se Krishti banon në mua, dhe përderisa fuqinë do të ma japë Ai, unë do të zgjedh të bëj sot atë që dua më shumë, jo atë që më duhet tani shpejt e shpejt.

“Prit pak, pastor, se po e ekzagjeron pak, sepse nuk është aq e lehtë.” Mos mendo se unë dhe gruaja ime e kemi më të lehtë se ju; fakti që jemi drejtues nuk na jep imunitet. Jetojmë në të njëjtin qytet, të rrethuar nga të njëjtit tundime. Forca tërheqëse e mëkatit dhe natyrës së vjetër në mua është aq reale sa është edhe te ti.

Natyrshëm, si njeri, unë nuk jam i disiplinuar, por Fryma që jeton brenda meje, dhe që është e njëjta Frymë që jeton brenda teje, më ndihmon të jem më i disiplinuar në gjërat që kanë më shumë rëndësi.

Me fuqinë që më jep Krishti, e disiplinoj veten për të synuar atë që dua më shumë para asaj që dua tani.

Për mua, sa më shumë varem te Zoti, aq më krijues, aq më i zoti bëhem, aq më i dashur dhe i papërtuar jam.

Dhe sa herë që bën atë që urrej më shumë, ndihesh më i fortë dhe më i disiplinuar. Një nga gjërat që urrej është të ngrihem në 6:00; 6:15 desha të them, sepse në mëngjes çdo minutë gjumi ka rëndësi. POR sapo kam dalë nga ngrohtësia e krevatit, ai minut është i vështirë. POR kur mund atë minut dhe zgjoj fëmijët, i bëj gati, lexojmë një psalm sipas datës, lutemi me 2-3 fjalë dhe u

jap nga një përqaftim të mirë. Oooo, se ke idenë si ndihem, njeri më i disiplinuar në botë!

Ose kur shkon në shtëpi dhe ke akoma monedha, dhe lekë të vogla nuk i ke prishur të gjitha, të jep ndjesinë se mund ti menaxhoj, mundem.

Kam 5 minuta kohë të lirë, dhe në vend që të postoj në Instagram, po lexoj një kapitull nga Bibla që kam në celular dhe e ndjej direkt që jam më afër Perëndisë.

Sfida e parë që has është se, në vend që të gjej kush e ka fajin, e sjell para Perëndisë me lutje. Si rezultat, dita ka për të qenë më produktive.

Kur nuk ngrihem herët, nuk ndihem mirë për veten time; kur s'ndihem mirë, ha ca për të gjetur diçka të lehtë. Kur ngrihem vonë, s'kam kohë të lexoj Biblën. Kur s'kam kohë me Zotin, i zgjidh problemet sipas mendjes time. Kur jam me nerva, nuk lexoj Biblën në celular, luaj ndonjë lojë në celular. Kur del problemi, dua të di së pari kush e ka fajin dhe çfarë duhet të bëjë ai person ndryshe; nuk më vjen të lutem për atë problem.

Dhe kur ndodh kjo, unë nuk jam produktiv atë ditë. Prandaj, mos u bëj si pastori. Pse? Sepse ai nuk zgjohet herët në mëngjes dhe gjithë dita i shkon lëmsh. Po e ekzagjeroj pak, por besoj se e dallon se çfarë dua të them.

**Kur Perëndia më ndihmon që të zgjedh atë që dua më shumë dhe jo atë që dua tani, krijon momentum në ditën dhe jetën time, më jep vrull.**

Prandaj dua të pyes edhe ty këto dy pyetje: (shpërndahen fletë dhe stilolapsa në sallë)

### **1.Çfarë dua unë më shumë?**

Kjo është e lehtë fare. Dua shumë që ta mendosh dhe ta shkruash në fletën, diku në celularin tënd.

Dikush mund të thotë: "Dua të arrij filan gjë," sepse ti tashmë e ke vendosur si synim. Dikush do të dobesohet 10 kg, dikush thotë: "Unë dua të lidhem, fejothem, martothem." Jo të gjitha për njëherë, por në varësi të momentit ku je.

Ose mund të thuash: "Dua të jem më afër Perëndisë." Ose: "Dua që familja ime të jetë këtu," ose: "Të ketë diçka këtë muaj." "Dua të mbyll të gjitha borxhet," "dua të filloj punë," "dua ta mbyll sezonin dhe vitin me kaq mesatare."

Shkruaje, çfarë do ti më shumë këtë vit?!

### **2.Si të disiplinoj veten time në një gjë?**

Folem për fjalën, mendimin, thënien, tani e ka rradhën disiplinë.

Për ta bërë më të lehtë, do të bëj disa pyetje që ti të vendosësh se çfarë discipline do të ushtrosh më shumë, çfarë do t'i shtosh jetës tënde që jeta jote t'i sjellë pak më shumë lavdi Perëndisë.

Çfarë do bësh sot që të kesh ose arrish atë që do më shumë?

Apo më thjesht, çfarë do t'i shtosh jetës tënde, një disiplinë të vetme për të shkuar drejt asaj që ti do më shumë?

S'duhet të jetë e vështirë.

- Do bëj një plan leximi të Biblës dhe do e filloj me dikë që të mbajmë përgjegjës njërin-tjetrin.
- Do bëj këtë ose atë për shëndetin.
- Do bëhem pjesë e një grupi të vogël, ose do të filloj vetë një grup të vogël.
- Do vendos Zotin të parin te paratë e mia, do jap 1/10.
- Kaq darka në javë do hamë si familje, për të martuarit.
- Do e filloj ditën me Perëndinë.

Çfarë është një gjë që do të fillosh të besosh sot që më vonë të kesh atë që po synon të kesh? Ajo që do më shumë.

Vete nuk mundem, por me Perëndinë mundem, sepse Ai do të sigurojë fuqinë dhe energjinë që më nevojitet.

**Vetëm një disiplinë...**

Fjala ishte: **Forcohuni.**

Mendimi: **Do të forcoj atë që kam...**

Thënia: **Unë jam i/e fortë në Zotin.**

Disiplina...

Sepse një gjë e vogël, një gjë që s'e sheh askush, ka për të sjellë ndryshimin që do çdo njeri.

Do ta ushtroj trupin tim siç stërvitet një atlet, do ushtroj mendjen time... Sepse do të vrapoj me qëllim çdo hap.

Mëkati do mundohet të më largojë nga shinat, nga vullneti i Perëndisë, por Fryma e Perëndisë do më mbajë afër Tij.

Prandaj, i kërkojmë fuqisë së Frymës së Perëndisë, bëj tek ne atë që ne nuk e



bëjmë dot.

Dhe kur jemi besnik me të vogla, Perëndia do të na besojë shumë më të mëdha.

Një ditë, kur Perëndia të japë mundësinë për të ndikuar më shumë njerëz, për të sjellë ndryshim të madh në këtë qytet dhe vend, dikush do të pyet: “Të lutem, a mund të më tregosh diçka? Çfarë gjërash të mëdha ke bërë që ke arritur deri këtu?”

Ti, me një buzëqeshje në fytyrë, do të thuash: “E di çfarë? Nuk kam bërë gjëra të mëdha, në fakt, por ato gjërat e vogla që nuk i sheh njeri sjellin ndryshim të madh që e do çdo njeri.”

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.